



► **MINISTRI NË KONFERENCËN "INTEGRIMI DHE BASHKËPUNIMI I KOMUNITETIT SHQIPTAR NË ITALI MIDIS SUKSESËVE DHE VËSHTRËSIVË"**



► **MBLEDHJA E RADHËS E GRUPIT TË KOORDINATORËVE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**



► **NGRIHET GRUPI I PUNËS PËR PËRGATITJEN E PLATFORMËS SË PROGRAMEVË TË DEDIKUARA PËR DIASPORËN**

# NEWSLETTER E DIASPORËS

REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN



AGJENCIA  
KOMBËTARE E  
DIASPORËS



FONDI SHQIPTAR  
PËR ZHVILLIMIN E  
DIASPORËS



QENDRA E  
BOTIMEVE PËR  
SHQIPTARËT E  
DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,

DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRIË

DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

## Prezantohet Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

*"Fondi është një krijim ambicioz, po aq edhe një platformë e hapur bashkëpunimi për projekte të cilat kanë lidhje me realizimin e një marrëdhënie të konsoliduar midis vendlindjes dhe Diasporës"*



Ministri i Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko prezantoi Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, një nga tre strukturat kryesore të cilat do të aplikojnë politikat e reja shtetërore për Diasporën shqiptare. Në fjalën e tij përshëndetëse ministri tha se Fondi ka garancitë e nevojshme juridike të një institucioni publik jobuxhetor i cili kërkon të hapë një faqe të re marrëdhëniesh me donatorët e interesuar. Ministri theksoi se krijimi i Fondit është shprehë e faktit se migracioni shqiptar po del nga faza e stacionit të pas viteve '90-të në Perëndim.

"Migracioni shqiptar ka filluar të organizohet dhe ambicet e tij janë të mirëkuptueshme" – tha ministri. Drejtoresha Ekzekutive e Fondit, znj. Soana Jaupllari bëri një prezantim të misionit të institucionit, duke u ndalur tek projektet konkrete që ky fond do të realizojë për të mbështetur anëtarët e Diasporës për të dhënë kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore e shëndetësore.



### Qendra e Botimeve për Diasporën nis punën

Në takim ku ishte i pranishëm Ministri i Shtetit për Diasporën dhe drejtori i QBD-së, z.Abraham Gashi, Këshilli Koordinues zgjodhi kryetare, znj.Persida Asllani, e cila aktualisht drejton Bibliotekën Kombëtare. Misioni për të cilin është krijuar QBD-ja është botimi i teksteve të cilat do të shërbejnë Diasporës. QBD-ja do të ndihmojë zhvillimin e procesit mësimor të gjuhës shqipe në Diasporë duke kontribuar në ruajtjen e kultivimin e identitetit kombëtar, gjuhësor, kulturor e arsimor të Diasporës me vendin e origjinës. Në mbledhje u diskutua edhe për hartimin e kurrikulave të përbashkëta me Kosovën, Maqedoninë dhe Malin e Zi.



## Reforma e politikave shtetërore për Diasporën në një botim të plotë

Politikat e reja shtetërore të hartuara nga Ministri i Shtetit për Diasporën botohen për herë të parë në përmbledhjen "Politika shtetërore për Diasporën". Rreth një vit më parë Shqipëria nuk kishte legjislacion apo strategji për shtetasit dhe bashkëkombasit e saj jashtë vendit. Pas një pune voluminoze të institucionit të Ministrisë së Shtetit për Diasporën vjen në një botim të plotë gjithë korniza e re dhe e plotë ligjore, që nga krijimi i institucioneve shtetërore, shtimi i burimeve financiare, materiale e njerëzore për këtë qëllim etj.

Materiali i paraqitur në këtë botim shërben për informimin e shtetasve shqiptarë brenda dhe jashtë vendit për ecurinë e detajuar të strukturave shtetërore dhe legjislacionit të ri për marrëdhëniet me Diasporën shqiptare.

Reforma e politikave shtetërore në fushën e Diasporës mbështetet në kërkesat imediate për implementimin e plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë por edhe me promovimin e angazhimit të Diasporës me vendin e origjinës si dhe qasjen drejt një ndërgjegjeje evropiane për rëndësinë e Diasporës në ndërtimin e urave lidhëse midis vendeve pritëse dhe vendit të origjinës etj.

PUBLIKOHET  
STUDIMI  
"DIASPORA E  
SHQIPËRIË"

Diaspora e Shqipërisë  
në Shifra



INSTAT me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Diasporën publikon për herë të parë një studim mbi Diasporën të titulluar "Diaspora e Shqipërisë në Shifra". Ky publikim kryhet në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Diasporën. Qëllimi i tij është vlerësimi i numrit të Diasporës shqiptare dhe profilin e saj mbi karakteristikat bazë demografike dhe sociale.



### KONFERENCA PËR 18 DHJETORIN "DITA KOMBËTARE TË DIASPORËS"

Ministri i Shtetit për Diasporën z.Pandeli Majko organizoi një konferencë ku u bë përmbledhja e një viti pune intensive në lidhje me Diasporën shqiptare. Në fjalën e tij z.Majko tha se shteti shqiptar po mbush boshllëkun e plotë në informacion dhe në strategjinë e Diasporës.

*"Një vit më parë, Shqipëria nuk kishte legjislacion apo strategji për shtetasit e saj jashtë vendit. Dokumentet e para në qeverinë shqiptare kaluan me shpejtësinë e vetëdijes për kohën e humbur."*

Pandeli Majko  
Ministër i Shtetit për Diasporën

## Takimi i dytë i nivelit të lartë në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit për Remitancat

Ky takim u zhvillua në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit "Për Remitancat" të nënshkruar vitin e kaluar nga Banka e Shqipërisë, Ministri i Shtetit për Diasporën dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi zhvillimet e arritura përgjatë vitit të parë pas nënshkrimit të memorandumit, si dhe synimet dhe nevojat për ndërhyrje të përbashkëta në të ardhmen, për përfshirjen e Diasporës dhe emigracionit në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e vendit. Gjatë fjalës së tij Ministri i Shtetit për Diasporën tha se në Shqipëri si në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, shumat që hyjnë në emër të remitancave janë shumë më të mëdha se sa ato që hyjnë në emër të investimeve të huaja.



*"Çështja e trajtimit të të ardhurave nga remitancat është një çështje e dorës së parë në zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo është një sfidë e të ardhmes me të cilën Shqipëria nuk mund të përballë seriozisht pa një dialog me sistemin bankar vendor. Pa një politikë të përbashkët për këtë çështje do përballlemi shpejt me ndryshimin e mënyrës së migrimit dhe bashkimit familjar në një periudhë afatmesme. Ajo pritet të ndikojë negativisht në konsumin dhe në ekonominë vendore, për shkak se migrantët nuk do të kenë kujt t'i dërgojnë të holla në vendlindje."*

Pandeli Majko  
Ministër i Shtetit për Diasporën

